



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 20.05.2020, me fillim në ora 10.00. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes, nënkryetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

REND DITE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Propozim vendimit për bartjen e tejkallimit të të hyrave vetanake nga viti 2019,
3. Shqyrtimi i vendimit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë,
4. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme – lokaleve afariste të Komunës më shfrytëzim personave juridik,
5. Raporti i DKA-së për ecurinë e zhvillimit të mësimi online/ në distancë,
6. Të ndryshme .

Kryesuesi – E vë në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar – A ka dikush diçka rreth procesverbalit.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, nënkryetarin, kolegë këshilltarë, drejtorët dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë kam një ndërhyrje në faqe 4, të diskutimi im rreshti i dhjetë, elementi kryesor i punës së qeverisë lokale dhe është indikator pasi ne e vlerësojmë edhe performancën, pra këtu është dashur të jetë sipas së cilës ne e vlerësojmë performancën e komunës d.m.th. të fjala “pasi” duhet të përmirësohet sipas së cilës. Për ndryshe kam vërejtje si duket mungesë të lektorimit sidomos në shenjat e pikësimit dhe duhet të ketë kujdes procesmbajtësi kur e bën procesin pastaj ka disa gabime teknike ka nevojë të shikohet të shumtë buxhetore që i kemi cekur p.sh. tek arsimi kemi përmendur 850 në 850,00 euro, pra ka nevojë të rishikohet pak më mirë ky procesverbal edhe të bëhet përmirësimi i këtyre gabimeve. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit z. Cena, kërkojmë nga sekretaria që të i përmirësojnë ato gabime, atëherë pasi nuk ka tjerë të lajmëruar, e qesim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Konstatojmë se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Propozim vendimit për bartjen e tejkallimit të të hyrave vetanake nga viti 2019.

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, ne e kemi pasur këtë pikë të rendit të ditës në mbledhjen e janarit, ku Kuvendi ka marr vendim vetëm për tejkallimin e të hyrave, kurse tani nevojitet vendimi për bartjen e këtyre të hyrave. Për këtë pikë e ftoj drejtorin z. Afrim Limani.

Afrim Limani – Përshëndetje për ju kryesues, nënkryetarin, ju anëtarë të KPF-së dhe gjithë të pranishmit në sallë. Në fakt ashtu siç tha edhe kryesuesi kjo pikë ka kaluar nga ana juaj në seancën e janarit me 30 janar të këtij viti mirëpo Ministria e Financave përkatësisht departamenti i buxhetit nuk e ka aprovuar këtë vendim me arsyetimin sepse në kryetitull duhet të shkruhet vendim për bartjen e tejkallimit e të hyrave, kurse ne e

patëm shkruar vetëm vendim për tejkalimin e të hyrave dhe pikërisht kjo është arsyeja edhe ata nuk kanë mundur sipas ligjeve që janë në fuqi me procesu me tjetër. Atëherë në bazë të kërkesës se tyre ne e kemi sjell edhe njëherë në Kuvend dhe tash dallimi është vetëm përshkrimi i kryetitullit pra tash që është propozim për bartjen e tejkalimit të të hyrave. Në fakt është shuma e njëjtë e tejkalimit po ashtu janë edhe projektet e njëjta të cilët kemi marr një vendim për bartje të këtyre të hyrave të cilët kanë kaluar jashtë mbi proceset e planifikimit të hyrave vetanake pra krejt kjo është ndryshimi, andaj kërkojmë edhe njëherë të hyjnë në Komitet dhe Kuvend dhe të votohet. Faleminderit!

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, nënkryetarin, anëtarët e KPF-së, drejtorët, po ashtu e përshëndes Hazizin në emër të OSBE-së dhe LMT-së dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë mendoj që duhet me qenë pak më me nivel, pasi ne jemi komunë dhe kur të vijmë çështjet për me marr vendime të caktuara, që është edhe Zyra Ligjore dhe është mirë me kohë këto gjëra të shikohen, e jo të kthehen dokumentet edhe njëherë që të rishqyrtohen. Nuk është që është bërë ndonjë problem i madh por duhet të jemi me serioz sikur të kishte kaluar në raundin e parë ashtu siç kemi marr vendim, ndërsa sa i përket këtyre pikave të rendit të ditës ne veç i kemi kaluar këto dhe nuk do të diskutojmë diçka me shumë. Faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit z. Fazliu, atëherë pasi që nuk kemi tjerë të lajmëruar e qesim në votim pikën e dytë të rendit të ditës. Konstatojmë se unanimisht aprovohet pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Vendimit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtorë, anëtarë të KPF-së. Pra bëhet fjalë për pikën e njëjtë që kemi kaluar në muajin mars, për zonën kadastrale në Malësi të Vogël. Qëllimi pse na e kemi sjellë këtë pikë në KPF dhe pastaj në Kuvend është sepse sipas kërkesës së kryetarit të Këshillit të fshatit më Malësi të Vogël është kërkuar një sipërfaqe për ndërtimin e një objekti që do t'i shërbej interesave të fshatit. Ne kemi marr vendim mirëpo në vendim edhe pse janë prezantuar skicat pra skicat e njëjta që i kemi sot ishin të prezantuara edhe në muajin mars. Kjo sipërfaqe prej mbi 7 ari i prek 3 parcela d.m.th. merr prej parcelës me numër 3910/1 pra prej kësaj parcele të trijat janë parcela shtetërore merr 136 m2, prej parcelës se dytë që është pronë shtetërore e Kosovës 1646 merr sipërfaqe prej 65m2 dhe prej parcelës se tretë e cila edhe kjo është pronë shtetërore e Kosovës 303/0 merr 577m2. Ne në vendimin e fundit në mars kemi përmendur vetëm një parcelë dhe tash kur ka ardhur koha për me azhurnua pra me përditësua këtë vendim nuk kemi pasur të drejtë me i shtua edhe dy parcela tjera edhe pse kemi marr ligjshmërinë prej MAPL-së, andaj kemi menduar edhe kemi kërkuar prej juve që të shfuqizojmë vendimin e muajit mars dhe të sjellim vendim tjetër ku do t'i ndahet kjo sipërfaqe në periudhë afatgjate prej 99 vite Këshillit të fshatit Malësi e Vogël, për interes të përgjithshëm të fshatit në afat prej 99 vite pa të drejtë që me i kaluar personave të tretë. Kërkoj nga anëtarët e KPF-së që pas shqyrtimit të aprovonë kërkesën e propozim vendimit për me kaluar në Kuvend vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë. Faleminderit!

Fehmi Cena – Është e vërtetë se ne në një mbledhje paraprake edhe si KPF edhe si Kuvend Komunal kemi marr një vendim që t'i përgjigjemi pozitivisht kërkesës së Këshillit të fshatit Radostë që ta merr këtë sipërfaqe pronë e Komunës prej 769 m2 për nevoja të fshatit apo siç thonë ata me ndërtua një odë për aktivitete të ndryshme të fshatit. E tha edhe drejtori se atëherë ka qenë vetëm një parcelë kurse tash po thotë 3 parcela, kjo po me intereson dhe pyetja është se pse u deshtë 3 parcela me u përfshije me një terrene prej 7.69m2, ndoshta pak po komplikohet situata edhe procedurat janë më ndryshe, nuk ka mundur me u krye me një parcelë apo si është gjendja e tanishme. Faleminderit!

Florida Bajraktari – Faleminderit kryesues. Ne si grup e përkrahim propozimin e kryetarit për dhënien e pronës së paluajtshme lokaleve afariste të komunës së Rahovecit në shfrytëzim personave juridik, pasi që qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe aktiviteti i zhvillimit biznesor, kështu që ne e përkrahim këtë propozim. Faleminderit!

Afrim Oruqi – Edhe pse kryesia e fshatit Malësi e Vogël ka kërkuar me shume se 7 ari, ne jemi kujdesur dhe me gjeodetë kemi dalur atje në terren dhe jemi kujdesur që me u largua prej rrugës kryesore Malësi e Vogel-Ratkoc d.m.th. kemi lanë hapësirë të mjaftueshme dhe jemi kujdesur këto rrugë dytësorë që hinë në fshatë mos me i prekë dhe na është dashtë me zvogëluar sipërfaqen me dhanë në shfrytëzim jomë shume 7.69 m2 dhe me i prekë 3 parcelat shtetërore që me krijua hapësirë pranë rrugës kryesore që me pas mundësi me

krijua trotuare dhe kanal të ujit që mos me i prekë rrugët dytësore që hinë në fshatë dhe komunitetin romë që jeton përkaj këtyre parcelave d.m.th. krejt kjo na ka imponua neve që me ju përshtat dhe me i prekë 3 parcela dhe mos me i prekë interesat e tjera të përgjithshme. Faleminderit

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor, atëherë pasi që nuk ka asnjë pyetje tjetër, e qesim në votim pikën e tretë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme – Lokaleve afariste të Komunës në shfrytëzim personave juridik.

Artan Asllani – Faleminderit kryesues, përshëndetje për nënkryetarin, anëtarët e KPF-së, kolege drejtorë dhe gjithë të pranishmit në sallë. Ne i propozojmë Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës se Rahovecit miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme lokale dhe afariste të Komunës në shfrytëzim të personave juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër nga 1-15 vite. Te pika 2,3 dhe 4 janë të specifikuara për metër katror çdo lokal dhe janë të shfaqur edhe numrat e parcelave edhe të këtyre lokaleve afariste komunale, që mund të i shikoni edhe të skicuara. Për mos me lexua për çdo njërin me numër të parcelave dhe hapësirën e këtyre lokaleve, unë do të flas shkurt, ne parcelën e lokaleve që gjinden në rrugën Xhelal Hajda gjithsej janë 5 lokale që janë të shfaqura edhe me numër të parcelave dhe hapësirave të këtyre lokaleve ndersa në pikën 3 janë gjithsej 13 lokale dhe në pikën 4 janë vetëm 2 lokale. Lokalet në pikën 2 gjinden ne rrugën Xhelal Hajda ndersa ne pikën 3 gjinden kryesisht në rrugën Avdullah Bugari ma saktësisht prej semaforëve deri te Ambulanta. Ndersa ne pikën 4 janë 2 lokale që gjinden hapësirën kadastrale ne Xerre me konkretisht të depot e Matrexit në Xërxe.

Çmimi i dhënies në shfrytëzim i pronave të paluajtshme të Komunës se lokaleve afariste të cekur në pikën 1,2,3 dhe 4 të këtij propozimi është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale si dhe mundësia e të gjitha bizneseve të ushtrojnë veprimtaritë e tyre në këto hapësira. Afati kohorë për dhënien e këtyre pronave të lokaleve afariste në shfrytëzim të cekur në pikën 1,2,3 dhe 4 është për dhënien në shfrytëzim për 10 vite. Çmimi fillestar i pronës komunale i cekur në këto pika përcaktohet në përputhje me rregulloren për taksa tarifa dhe ngarkesa ndersa të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës në dhënien në shfrytëzim do të rregullohet me kontratë të veçantë të cilën e nënshkruan kryetari i komunës dhe përfituesi për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme. Procedurat për dhënien e pronës se paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër realizohen nëpërmjet ankandit publik. Faleminderit

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues! E falënderoj drejtorin që na njoftoi me këtë pikë të rendit të ditës. Drejtori mirë e ka cekë se në bazë të kontratave, që e kanë pasur deri me 31.05.2020, me i shfrytëzua këto prona dhe po me vjen mirë që më herët i keni nisur procedurat, sepse ne edhe ne të kaluarën kemi pasur raste që ndoshta ju ka kaluar afati goxha shumë kohë edhe kanë mbetur në harresë dhe nuk janë paraqitur rastet e pastaj shumë me vonesë kemi marr qëndrime por ajo që unë desha të them është që, në pikën e gjashtë afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, më siguri drejtori e din këtë punë, që kompetent për sa vite jepet është Kuvendi komunal dhe jo në mënyrë decitive e shkruar 10 vite d.m.th. për mbledhje të Kuvendit unë propozoj që në dokument të shkruhet prej 1-15 vite në bazë të ankandit publik, e pastaj ne jemi ata që marrim vendim sa vite e përcaktojmë, pra Kuvendi Komunal është kompetent, kështu që kjo të përmirësohet për mbledhje të Kuvendit Komunal. Desha një pyetje shtesë me ja bë drejtorit, që a ka prona komunale gjegjësisht se a ka lokale afariste tjera të Komunës që ju ka përfunduar kontrata e që nuk janë në këtë liste pra në këtë dokumente të paraqitur, pra a kemi raste të tjera apo jo? Desha si informatë me marr nga drejtori, përndryshe në mbledhje të Kuvendit do të japim kontributin, sigurisht që jemi për me ju dhanë mundësinë njerëzve me vazhdua punën me tutje. Po ashtu, edhe një pyetje tjetër është shfrytëzuesit e deritashëm që i kanë pasur këto lokale, a i kanë kryer obligimet ndaj komunës çka i kanë apo jo? Nëse i kanë kryer atëherë është mirë edhe ne si komunë me ju dhanë përparësi se vërtet kanë qenë kompetentë edhe i kanë krye detyrat ashtu siç duhet etj. brenda mundësive që i kemi. Ju faleminderit!

Fehmi Cena – Edhe për mua ky propozim është i qartë nga ana e drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, pra është fjala për lokalet afariste që janë pronë e komunës, të cilëve ju ka skaduar kontrata e qirasë që e kanë shfrytëzuar personat juridik deri tash, natyrisht që duhet të shkohet përmes ankandit. Edhe unë jam i

mendimit, që pastaj sidomos kur të shkohet në ankand duhet të përdoren ato kritere që janë më pozitive sikur që u cekë nga parafolësi, të vlejë për ata persona juridik që kanë pasur duke ushtruar veprimtarinë, që kanë pasur suksese të mirë, kanë pasur më shumë të punësuar pastaj sigurisht edhe që i kanë kryer obligimet ndaj shtetit. Unë jam që kjo të kalojë për Kuvend dhe ta bëjmë një diskutim më të gjerë.

Artan Asllani – Faleminderit shumë për pyetjet, në lidhje me pyetjen që e shtroi Rasim Fazliu, lokale të tjera komuna e Rahovecit nuk ka të evidentuara që janë të lira për dhënien në shfrytëzim përjashtimisht vetëm te Palestra mirëpo lokalet te Palestra nuk i kemi ende në rregulloren e përcaktuar për dhënie në shfrytëzim, që besoj që shumë shpejt do të hyn edhe draft-rregullorja në Kuvend dhe pasi të bëhet rregullorja e re atëherë besoj që ata lokale do të dalin në ankand. Ndërsa te pyetja e dytë, a kanë obligime këto lokale? Ne i kemi lajmëruar të gjitha këto biznese që ju skadon kontrata këtë muaj dhe i kemi lajmëruar që do të dalin në ankand dhe obligimet që i kanë të mbetura. Në bazë takimit që i kamë mbajtur me pronaret e këtyre lokaleve që ushtrojnë veprimtaritë e tyre për momentin, janë zotuar se shumë shpejt do t'i kryejnë obligimet ndërsa nëse mbesin obligime atëherë komisioni sigurisht se nuk ju jep përparësi në bazë të rregullores për dhënien në shfrytëzim edhe ata që kanë obligime nuk kanë të drejtë me u favorizua për me hy në ankand. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, e qesim në votim pikën e katërt të rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Raporti i DKA-së për ecurinë e zhvillimit të mësimin online/në distancë.

Avni Morina – Faleminderit kryesues, të nderuara anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe gjithë ju të pranishëm. Unë kam përgatitur një raport për këtë periudhë prej 12 marsit deri me datën 12 maj, për ecurinë e mësimin online në distancë i cili u imponua për shkak të kushteve që u krijuan dhe rrethanave nga Pandemia Covid-19. Raporti është afërsisht 27 faqe dhe mjaft i gjerë sepse kemi përfshirë raport ne detaje për të gjitha shkollat por unë do të ju lexoj fillimisht vetëm pjesën hyrëse dhe disa përfundime që i kemi në fund. Sikur në të gjitha komunat e Kosovës edhe në komunën tonë pas rrethanave të jashtëzakonshme të krijuara për shkak të përhapjes së Pandemisë Covid-19, edhe në komunën tonë filluam të angazhohemi të zbatojmë rekomandimet e MASHT-it për mësimin në distancë. Në bazë të raporteve nga shkollat fillore të mesme të ulët dhe nga shkollat e mesme të larta të komunës tonë, në periudhën prej 12 marsit mësimi online është realizuar në nivel jo të kënaqshëm, por marrë për bazë faktin se një sistem i tillë mësimi është realizuar për herë të parë dhe në rrethana të jashtëzakonshme. Gjatë kontakteve që kemi pasur me drejtues të shkollave dhe me numër të madhe të mësimdhënësve, kjo sfidë fillimisht është pritur me skepticizëm dhe rezerva mirëpo me angazhimin e DKA-së ku me ç'rast kemi formuar edhe një ekip për organizim të këtyre punëve dhe drejtoreve të shkollave sidomos të koordinatorëve të cilësisë, ky skepticizëm është kthyer në angazhim të madhe duke dhënë kontributin e tyre shumica e mësimdhënësve. Kjo punë është fuqizuar me krijimin e grupeve të klasave, nga ku mësimdhënësit kanë përcjell angazhimin e nxënësve përmes detyrave të dhëna gjatë mësimin online por edhe aktiviteteve të mësimdhënësve në klasat e tyre dhe lëndët e caktuara. Njëra ndër sfidat sipas mësimdhënësve ka qenë mungesa e pajisjeve teknologjike nga një numër i nxënësve me theks të veçantë me nxënësit të familjeve me raste sociale dhe të komuniteteve rom, shkali dhe egjiptas. Megjithatë mësimdhënësit nga shkollat kanë evidenca të sakta për numrin e nxënësve të përfshirë në këtë proces dhe për secilin shkollë kemi raporte të rregullta javore dhe mujore për ecurinë e mësimin në distancë. Këtu në këtë raport kemi në mënyrë tabelore të gjitha të dhënat për secilën shkollë, duke filluar në shtyllën e parë nga emri i shkollës pastaj platformat online të cilat i kanë përdorur mësimdhënësit e këtyre shkollave, numrin e nxënësve në secilën shkollë që është i përgjithshëm pastaj numrin e nxënësve të angazhuar në mësimin online, numrin e mësimdhënësve, numrin e orëve të mbajtura dhe lëndët mësimore që është shtylla e parafundit në të cilat është zhvilluar mësimi online. Gjithashtu në shtyllën e fundit janë edhe sfidat ose vështirësitë e aplikimit të mësimin online në distancë. Këtu janë të paraqitura për secilën shkollë në veçanti dhe si rezultat i të gjitha këtyre shënimeve që i kemi marrë dhe raporteve burimore prej shkollave, nga këto tabela shihet që gjatë kësaj periudhe numri i nxënësve që kanë mundur të përfshihen në mësimin online nga niveli zero deri te klasa 12 në Komunën tonë është 1674 nxënës ose të shprehur në përqindje nga numri i përgjithshëm është 17,6% e nxënësve që nuk kanë mundur të përfshihen në mësimin online. Siç e shihni nuk

jemi në nivelin është raportuar nga Prishtina pasi atje po flitet për 90-95% që janë të përfshirë, pra është një numër i madhe i nxënësve që nuk kanë mundur të përfshihen në këtë proces dhe arsyet e mos përfshirjes janë të ndryshme por kryesisht janë mungesa e teknologjisë së nevojshme informative tek nxënësit por edhe tek disa mësimitdhënës por edhe mungesa e përvojës, pasi është një përvojë e re që është aplikuar në sistemin arsimor të Kosovës por edhe rrethanat e kanë pamundësuar të bëhet një përfshirje e tillë. Sido qoftë në vazhdimisht po i përcjellim rekomandimet nga MASHT-i dhe sipas asaj që kemi marr nga MASHT-i presim në këto lëndet e mbetura që nuk kanë mundur të përfshihen nxënësit online dhe me këtë numër të nxënësve të cilët gjithashtu nuk kanë mundur të përfshihen në mësimin online, të organizohen teste të veçanta eventualisht gjatë muajit Qershor ndërsa në fillim të Korrikut parashihet që të mbahet testi maturës dhe testi i arritshmërisë mirëpo për datat ende nuk jemi të përcaktuar. Kjo është përafërsisht gjithë ajo, në mbledhjen e kuvendit do të flasim edhe me gjerësisht por u mundova ta përmbledhë pak a shumë. Faleminderit

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues! E falënderoj drejtorin për sjelljen e këtij raporti, për mësimin online gjatë kësaj kohe shumë të vështirë që e kemi për arsimin në Kosovë. Unë mendoj që ky është një hap i mirë që është marrë edhe prej organeve qendrore atje, edhe këtu në nivele komunale, gjë që i përshëndes, pasi e dimë se edhe ne kur kemi qenë nëpër dhoma të mësimi si mësimitdhënës nuk kemi mundur ndoshta me dhanë 45 minuta kontributin tonë qysh duhet mirëpo sidoqoftë e përshëndes, sepse edhe ne i kemi fëmijët nëpër shtëpitë tona dhe sigurisht e kam vërejtë që me aplikimin e mësimi online, megjithatë është bërë një aktivizim edhe te fëmijët, nuk është me rëndësi koha sa ata e ndajnë aty gjatë mësimi online por është e rëndësishme pastaj po jepen detyra dhe nxënësit po angazhohen, pra po interesohen sigurisht ata që po donë me u interesua, ndërsa për këtë raportin tonë që kemi komunale, shihet që nëpër disa shkolla, kjo tregon edhe shkallën e mësimitdhënësve tanë, në atë gjendjen se çfarë janë të ngritur për këtë çështje, pasi kemi këtu shkolla që numëron dy arsimtar, kurse ajo shkollë i numëron mbi 20 arsimtar pra kjo është për keqardhje, po flas për ata mësimitdhënës sepse mësimitdhënësit e kanë për obligim me ecë në hap me kohën d.m.th. me njohtë edhe teknologjinë dhe me pas njohuri për të gjitha gjërat, pra edhe në situata çfarë jemi, të jashtëzakonshme, me kontribua. Pra këtu janë disa shifra jo të mira, e aq me tepër unë dëshiroj me ditë edhe numrin e mësimitdhënësve që janë aktiv, që për këtë mësim shkruan dhjetë drejtorë i nderuar, e po shpresoj që ashtu që se paku dhjetë të jenë të aktivizuar pasi nuk duhet të jetë ashtu si formalitet që me i dërgua te drejtori kinse dhjetë mësimitdhënës janë aktiv. Për ndryshe po potencoj edhe njëherë, është mirë kjo që ka ndodhë sepse nxënësit sadopak janë aktivizuar në procesin e mësimi dhe janë aktivizuar në bërjen e detyrave por thash edhe njëherë vërejtjen e kam të mësimitdhënësve sepse u deshtë me qenë pak me aktiv pasi e merr rrogën edhe duke qëndruar te shtëpia edhe mos me marr asnjë masë të duhur për tu aktivizuar në procesin e mësimi online. Po ashtu kemi raste kur fëmijët ju ndihmojnë prindërve pasi janë në moshë edhe nuk kanë njohuri të mjaftueshme sa i përket përdorimit të teknologjisë bazuar në sistemin online dhe fëmijët ju ndihmojnë në këtë drejtim. Gjithsesi është për tu përshëndetur por me siguri që kemi mundur me bë edhe më tepër, pasi po flas për disa shkolla kur përmendet vetëm një mësimitdhënës aktiv kurse realisht shkolla iu ka mbi 20 mësimitdhënës. Faleminderit drejtor, unë vetëm e ngrita si çështje kurse sqarimet i pres me mirëkuptim. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit z. Fazliu, pajtohem plotësisht me mendimin tuaj edhe për punën e raportit të drejtorit që na ka sjell kërkojmë angazhimin edhe të mësimitdhënësve më tepër sa i përket aktivizimit online.

Fahrie Lushi – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, te nderuar kolegë këshilltarë dhe gjithë të pranishmit në sallë. E falënderoj drejtorin edhe unë për këtë informatë apo material që e ka përgatitë dhe që e ka sjellë në Kuvend mirëpo të gjitha shqetësimet që i shprehu pak më parë parafolësi janë shumë të vërteta dhe mbi të gjitha shqetësuese është ajo se angazhimi i mësimitdhënësve po ashtu edhe tek niveli zero që i kemi këtu edhe drejtori e din shumë mirë dhe mirë që e përmendi se në Prishtinë në platforma të ndryshme, unë e kam vajzën 4-vjeç dhe prej të hënës deri të premten na dërgohen platforma të përgatitura për këtë cikël dhe është plan programi punues. Mirëpo drejtori nuk duhet të merr përsipër edhe barrën e mos angazhimit të mësimitdhënësve, çfarëdo sqarimi që mundet të na jep, kjo është ajo që figuron këtu edhe drejtori vet e ka përgatitur këtë. Dhe mbi të gjitha është për tu përshëndetur ky angazhim dhe kjo formë e mësimi online sepse neve nuk na duhet e aq më pak ne duhet të krenohemi me mësimitdhënësit ose me angazhimin ose me organizimin e gjithë grupacioneve në këtë punë mirëpo mbi të gjitha është për ne e mirëseardhur që nxënësit

tanë të mos devijojnë dhe mos të mbesin anash pa u angazhuar në mësimet e tyre që ani pse për pak orë apo për pak minuta shpjegohen në platforma online mirëpo edhe bashkëpunimi në zoom përmes mësimdhënësve përkatës, pasi e kam djalin në klasë të dytë dhe mësuesja çdo ditë të javës një ditë e mban të hënën p.sh. e mban Matematikën kurse të martën e mban Gjuhë shqipe kurse të premten e mban Shoqëria e mjedisit e njeriut dhe natyra, kështu që e lusim drejtorin që të ketë me tepër mirëkuptim në shqetësimet tona sepse kjo është shqetësim për nxënësit dhe jo për punën e atij apo të këtij. Faleminderit!

Avni Morina – Këtij raporti i mungon numri i mësimdhënësve që nuk janë të përfshirë në sistemin online. Këtë kërkesë e kam bërë te drejtorët e shkollave pasi e kam hartuar këtë raporte d.m.th. pas datës 12 maj dhe po besoj që deri sa të vjen mbledhja e Kuvendit do të marr edhe numrin e mësimdhënësve që nuk janë të angazhuar. Aty në fillim të raportit është niveli zero dhe te niveli zero përfshihen sistemi parashkollor edhe është numri i punëtorëve që punojnë d.m.th. në atë shtyllë është vetëm numri i punëtorëve që i ka shkolla në atë nivele, pastaj në nivele të larta siç e shihni në tabelë të gjitha shkollat të niveleve i mesëm i lartë pastaj shkollimi fillor i mesëm i ulët e kështu me radhe dhe numri rritet pra aty është vetëm numri total i mësimdhënësve ndërsa numri i mësimdhënësve që nuk janë përfshirë nuk është i pasqyruar në raport edhe këtë do ta përfshijë në raport pasi jam duke i mbledhur të dhënat nga drejtorët dhe do ta përfshijë në mbledhjen e kuvendit po ashtu do ti jap edhe të dhënat në secilën shkollë sa mësimdhënës nuk janë duke u angazhuar në këtë drejtim dhe kam kërkuar seriozisht nga drejtorët e shkollave që të mi sjellin të dhënat e sakta për arsye se edhe nëse hiq nuk i duhen Kuvendit, ato me duhen mua si drejtori e Arsimit pasi kam rekomandim nga MASHT-i që gjate muajit Qershor të organizojmë teste të veçanta për këta d.m.th. edhe për nxënësit që s'kanë marrë pjesë që nuk janë pak që janë mbi 1600 pra 17.6% por edhe për ata mësimdhënës që qoftë për arsye të moshës nuk kanë mundur me zbatua këtë teknologji apo qoftë për arsye të mungesës se teknologjisë e kështu me radhë pra nuk kanë mundur të përfshihen në sistemin online dhe nuk kemi një përqindje që i afrohet 20% ta lëmë anash sepse edhe MASHT-i nuk e ka politikë atë. Pra kjo është ajo që nuk është numri aty dhe tjetra ne kemi pranua një udhëzues për vlerësimin e nxënësve qoftë të këtyre që janë përfshirë në sistemin online se si do të vlerësohen pra është udhëzues detal nga MASHT-i edhe ju kemi dorëzua secilit mësimdhënës e ka këtë nga niveli zero deri në klasat e 12-të e ka atë udhëzues tash sepse ju kemi përcjellë dhe përmes atij udhëzuesi do të vlerësohen nxënësit edhe pjesa që janë përfshirë në sistemin online edhe pjesa që nuk janë përfshirë. Sa i përket teknologjisë është e vërtetë, ndoshta unë nuk e di por unë për veti skish amujt me pranua shifra që janë fiktive p.sh. 95% janë të përfshirë në sistemin online prandaj kam insistuar vazhdimisht te drejtorët e shkollave që të më sjellin shifra sa me te sakta, për arsye se ne duhet ta dimë sa nxënës në Komunën tonë nuk kanë pajisje qoftë edhe një telefon të thjeshtë për me ndjekë mësimin online. Po ashtu kemi pasur një kërkesë edhe nga MASHT-i dhe ju kemi dërguar shënime, kemi shpresuar mos po na ndihmojnë, është ndarë një donacion nga Elkosi në nivele qendror atje me 13 laptop të vegjël na kanë takua neve si komunë dedikuar për shkollat e mesme edhe prej atyre 2 kanë qëlluar në gjendje jo të rregullt pra veç 11 janë në gjendje të mire edhe ata i kemi shpërndarë në rastet që kanë pasur nevojë në shkolla të mesme, pra kjo është ai sqarimi që desha të jap. Faleminderit!

Rasim Fazliu – Për shkak të informimit po dua me i ditë disa gjëra, po shkojmë konkretisht p.sh. po e marrim shkollën Isa Boletini, këtu po thotë që numri i mësimdhënësve që sigurisht që janë të përfshirë 3, atëherë pasi që qenka sipas niveleve, faleminderit për sqarimet drejtor edhe në Kuvend kemi kohë me diskutua por po e bëj pyetjen. Ky vit shkollor sipas Ministrisë së Arsimit a do të përfundoj pavarësisht gjendjes qysh e kemi edhe që nuk është zhvilluar mësimi i rregullt, do të përfundoj, sa mundeni me na dhënë informata rreth kësaj çështje. Faleminderit!

Avni Morina – Ne jemi në kontakt të përhershëm me Ministrinë e Arsimit pothuajse çdo ditë, dje se fundi kam folur me sekretarin e Ministrisë së Arsimit z. Agim Berdynaj dhe kërkoja sepse ende nuk kemi njoftim zyrtar pasi sipas kalendarit të vitit shkollor që është miratuar në shtator me 20 maj është deshtë me përfundua mësimi i rregullt për maturantët. Edhe kërkoja prej tyre që të na japin informacione zyrtar se kur përfundon edhe në këtë formë. Sipas tij, do të ju lajmërojmë shumë shpejt edhe sipas gjitha gjasave meqenëse nuk po varet prej vullnetit tonë por prej vullnetit të virusit Covid-19, ky vit do të përmbyllet në këtë formë, madje edhe testi i maturës dhe testi arritshmërisë që do të organizohen në fillim të korrikut është duke u përpiluar në formë që pyetjet të përfshijnë plan programin e datës para 12 mars dhe është reduktua edhe testi i maturës

nga 200 pyetje që i kanë pas, tash do ti kenë vetëm 100 pyetje edhe do të mbahet për një ditë d.m.th. është duke shkuar në atë formë ky vit të përmbyllet ashtu siç ka vepruar edhe shtetet tjera pra kështu ka vepruar edhe Shqipëria megjithëse Shqipëria janë para nesh në këtë drejtim sepse maturanët janë kthyer për ja dy javë nëpër shkolla, natyrisht duke ju përmbajtur rregullave të distancimit fizik dhe dezinfektimit etj. Te ne nuk ka një iniciativë të tillë të paktën për 2 apo 3 javë të kthehen nëpër shkolla sepse edhe nuk po varet prej neve pasi po ka raste të përditshme pozitive me Covid-19 dhe sot me u ndal sipas infektologëve që kam dëgjuar sot me u ndal virusi edhe mos me pas më raste në Kosovë, duhet me prit dy javë ditë që mos me u paraqit asnjë rast pastaj me kalua në normalitet. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit Drejtor për sqarimet, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Te ndryshme.

Atëherë pasi që nuk ka diçka sa i përket pikës në të ndryshme, unë do të ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, po ashtu ju informoj se mbledhjen e rregullt të Kuvendit e planifikojmë me datën 29 të këtij muaji (e premte) dhe faleminderit shumë të gjithëve për kontributin e dhënë dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoj 11:00

Procesmbajtësi

Agim Hoti

